

# 1

## Varrosur për së gjalli

**D**ëshira e fundit e tezes ishte që një ditë pasi të varrosej ta thërrisnim tri herë në celularin që do ta groposnim së bashku me të. Në mëngjes, në mesditë dhe në mbrëmje, kështu shkruante me dorëshkrimin e saj si prej fantazme që na priti, së bashku me sendet e saj personale në azilin e pleqve në Pilë.

Më shumë se nga vdekja, ajo frikësohej se mos e varrosnin të gjallë dhe kjo frikë i ishte bërë fiksion vitet e fundit qëkur mbeti uloke.

Para njëqind vjetësh një kushërirë e saj e largët, kishte pas qenë gjoja varrosur e gjallë në Boninovë, menjëherë pasi trualli ku kishte qenë bordeli i atjeshëm ishte shndërruar në varrezë. E gjetën kur hapën varrin e saj për t'i bërë vend një të vdekuri tjetër. Në arkivol gjetën rroba të shqyera dhe kocka të thyera të këmbëve dhe të duarve gjë që u interpretua sikur ishte një përpjekje e pasuksesshme e saj për t'u çliruar nga vdekja dhe burgosja e tmerrshme. Megjithëse ekzistonte edhe një teori tjetër, se të ndjerën ishte përpjekur ta nxirrte, me shumë mundime, punonjësi i varrezave në kërkim të arturinave me të cilat varroseshin atëbotë pjesëtarët e familjeve aristokrate të kohës. Ky i shkretë na paskësh dashur dëshpërimisht të shpëtonte familjen e tij të varfër nga uria. Një kushërirë ynë ka pas shkruar në vitet shtatëdhjetë një fejtון në gazetën *Vjesnik* në lidhje me këtë ngjarje. Gjendja vegetative në azil, e lënë

në mëshirën e mendimeve të saj ogurzeza, i kishin hapur mjaft rrugë fantazisë së tezes për të ecur në këtë drejtim.

Vëllai edhe unë qëndruam në Dubrovnik edhe një ditë të tërë pas varrimit në mënyrë që të përmbushnim dëshirën e saj të fundit. Asnjë pjesëtar i familjes tonë të gjerë që vazhdonte të jetonte në Dubrovnik, nuk desh të merrej me këtë punë prej të luajturi. Për hir të së vërtetës edhe im vëlla kundërshtoi, por arrita ta bind në njëfarë mënyre që të qëndronim dhe të përmbushnim kësajsoj këtë dëshirë të fundit të tezes, sado e kotë që të ishte. Tezja nuk kishte fëmijë të saj, sepse nuk ishte martuar kurrë, ndërsa kushërinjtë e tjerë ishin nga ai soji i njerëzve të ftohtë nga të cilët as pret dhe as kërkon asgjë dhe vazhdon të mbash distancë edhe në jetën e përtëjvarrit. Nëna jonë ishte e pafuqishme për të ardhur në varrimin e së motrës. Për më shumë, Dubrovniku dukej nga Zagrebi sikur të ishte në fund të botës, diku atje larg në rrethrotullimin e Jarçevës. Në vitet e fundit, vëllai dhe unë ishim të vetmit nga pjesa “veriore” e familjes të cilët, një herë në vit e nganjëherë edhe më rrallë se kaq, vinim për të vizituar tezen. Një vit në sistemin e referimit të veriorëve kalonte shumë shpejt, ndërkohë që tezja jonë këtë vit ishte e përqendruar në rrënimin e saj që kryhej ngadalë, në mënyrë të pakthyeshme dhe të papërballueshme. Nga patericat, nëpërmjet karrocës me rrota deri te qëndrimi shtrirë pa lëvizur. Këto ishin stadet e dorëzimit të saj të ngadaltë, në fillim me gjurin e thyer, pastaj me hemorragjinë cerebrale, e në fund me thyerjen e kockës së femurit që e ankoroi përfundimisht në shtrat. Që me aksidentin e parë, i cili në krahasim me ata që do të vinin dukej fare pa rëndësi, ajo nënshkroi kapitullimin pa kushte dhe e la veten në rënie të lirë në humnerë e cila një ditë përfundoi. Herën e fundit që e vizituam teksa ishte ende gjallë, para diçka më pak se një viti, qëndronte e palëvizur në krevat, e tharë, e ngurosur,

ndoshta edhe e droguar prej ilaçeve që personeli i azilit ia injektonin në vena pleqve për të mos bezdisur të tjerët duke thirrur ndihmë. Protezat e dhëmbëve nuk e vinte më në gojë, e për pasojë buzët i ishin hyrë në brendësi të fytyrës së zhubravitur që dukej si fik i tharë. Humbiste në peshë në mënyrë konstante. Hante si zog, vetëm sa për t'u mbajtur në jetë, sa nga pafuqia, sa nga dëshpërimi, e sa nga ilaçet që shuanin te ajo çdo shkëndijë jete. Këmbët e saj të holla të mbështjella me pelena me muskujt e atrofizuar dhe lëkurën e zhubrosur të shtrira në dyshek, dukeshin si krahë zogu të shpupluar. Mezi e kuptonim se çfarë fliste megjithëse ajo nuk fliste ndonjë gjë të tepërt. Ndërsa sytë, ishin të vetmet që ndiznin pa ndërprerje atë shkëndijën e fundit, duke lëshuar një trishtim të papërballueshëm që humbiste në horizont diku mbi kokat tona. Nganjëherë më ndodhte që në përballje me këtë shikim të shkrehesha në vaj. Ndoshta nuk ishte vaj për atë. Ishim larg, ne në Veri ajo në Jug, ishim mësuar me kohë të jetonim njëri pa tjetrin. Ishte vaj për atë që po ndodhte, por edhe për atë që do të na ndodhte neve, të pafuqishmëve dhe të brishtëve, me afat kohëzgjatjeje paksa më të madh sesa jeta mesatare e brumbujve. Në ato momente ajo zgjaste drejt meje me dëshpërim duart e saj të thara dhe tërë kocka me thonj të paprerë. Kjo lëvizje gjithmonë më frikësonte dhe më shqetësonte. Më kujtonte faktin sesi mbeteshim tërësisht të vetmuar në lëvozhgat tona.


Në takimet tona të fundit teksa ajo ishte ende në këmbë, në shtëpinë e saj, me trupin e saj dhe me shpirtin e saj të njohur, vazhdimisht ankohej për qytetin. Këtë fjalën e fundit ajo e shqiptonte *qitet*. *Nuk ka më asnjë dyqan normal në qitet. Nuk kam ku të ndreq orën e dorës në qitet. Sheshet e qitetit janë shndërruar në dyqane suveniresh. Nuk mund të gjesh askund një ëmbëlsirë që t'ia vlejë. Vetëm arançata. Limonada, biskota mbështjella me celofan, sikur ne në qitet jetuakemi vetëm*

*me ato. Nuk kam ku të blej lule për të dërguar në varreza. Nuk kam ku të shkurtoj kapotën, as të ngushtoj mesin. Në qitet na vinë kruzerë më të mëdhenj se vetë qiteti. Më duhet të shkoj në Gruzë për të gjetur ushqim për macet.*

Ushqente një çetë të tërë macesh. I vinin poshtë ballkonit të saj që shihte nga ana e kishës ortodokse. Ishte një parajsë e vërtetë. Ankohej për zhurmën që vazhdonte deri në orën pesë të mëngjesit. Edhe për rrëmujën e tmerrshme gjatë verës. Nuk e merrnin shumë seriozisht këtë ankim të saj. E konsideronin pjesë të veçantisë së saj dhe pjesë të folklorit të përkëdhelur dubrovnikas. Megjithëse, para më shumë se pesë vitesh, kishim shëtitur së bashku me të nëpër shëtitoren kryesore të quajtur Stradun, ku shumë rrallë i takonte që të shihte të njohurit e saj. Po zhdukeshin dalëngadalë. Kur ndodhte që takoheshin, ankoheshin për atë që ishte shndërruar *qiteti*. Dhe se si *duhej ikur nga qiteti*. Fjala *qitet* dëgjohej gjithnjë e më rrallë nëpër rrugë.

E varrosëm në varrezën familjare në Boninovë. U mblodhën disa miq, pak përfaqësues të institucionit ku kishte punuar kur ishte gjallë dhe disa kushërinj. Celulari u gropos së bashku me të, ashtu siç desh. Para kësaj e mbushëm me kredite dhe ngarkuam baterinë. Dielli lart në qiell. Dukej sikur gropa e zbrazët kullufiste shkretëtirën e zbrazët në largësi.

Ishte mëngjes. Një ditë pas varrimit. Vëllai dhe unë qëndronim në shtëpinë e saj në qytet. Kishim kaluar një natë pa gjumë në të cilën lumenj njerëzish kalonin nëpër gjendjen tonë gjysmë të përgjumur. Qëndronim në shtëpinë e cila ndërkohë e kishte harruar tezen. Nuk kishte banuar në të që prej një kohë të gjatë. Kishin pas banuar këtu miqtë e miqve të saj, dhe për pasojë gjërat e saj i kishin mënjanuar pa e vrarë mendjen nëpër raftet, në kuti dhe në qese plastike. Ato, unë dhe im vëlla do të duhet t'i dërgojmë ndokund për t'i evakuuar, ndoshta përsëri në azilin e pleqve ose në



Karitas. Në kredencat e kuzhinës ka disa qese me çaj indian. Pluhuri kishte zënë vend në të gjithë këndet e banesës. Rrjetat e merimangave ishin grumbulluar nëpër anijet dhe varkat në miniaturë që ajo i kishte ndërtuar aq bukur sa ishte gjallë dhe e fortë. Biblioteka shtrinte më kot krahët saj për ta përqaftuar atë. Në vend të saj erdhën vetëm disa sende që i sollëm nga azili i pleqve. Çanta e dorës mbushur me dokumente, pizhamet, manteli i shtëpisë, dy libra me kapakë të zbukuruar me autorë emrat e të cilëve nuk i kisha dëgjuar dhe të cilët ndoshta i kishte dhuratë nga ndokush, disa numra të revistës “Gloria” dhe një rezistencë për ngrohje. I lëshuam në dysheme para kolltukut duke i bërë të dukeshin akoma më shumë trishtuese.

Gjithsesi kjo nuk ishte më banesa e saj. Që në fillim të viteve nëntëdhjetë ia kishte lëshuar një kushëriri të pasur nga Amerika e Jugut në mënyrë që ai të merrej me blerjen e saj nga shteti. Ai tani jetonte diku poshtë rrethrotullimit të Jarçevës. Ia kishte dhënë praktikisht badihava para se çmimet e banesave në qytet të fillonin e të ngriheshin çmendurisht. Pas kësaj vlere e banesës kërceu me 1000 për qind më shtrenjtë. Kësisoj, kapitali i kushëririt të pasur nga Amerika e Jugut u rrit pak më shumë, ndërsa ajo mbeti e sigurt me banim deri sa të vdiste. Shpejt dhoma, kuzhina, banja dhe ballkoni i saj do të shndërroheshin në apartament për turistët.

Duhej të shkonim te varreza dhe ta thërrisnim në celular. Tri herë gjatë ditës së sotme. Vëllai ishte nervoz sepse i duhej të kryente një program kompjuterik për një firmë dhe t’ia dërgonte urgjentisht po asaj firme me seli diku në anën tjetër të botës. Madje duhej ta kishte bërë që dje. Atij i dukej absurde ideja për ta thirrur. Më tha se do ta kishim më komode të niseshim për Zagreb dhe të thërrisnim diku gjatë autostradës, nëse vërtetë duhej ta thërrisnim. Të varrosesh për së gjalli në shekullin

21, shekulli i diagnozave precize, ishte gjë e pamundur nga ana shkencore. Por ajo kështu desh, i thashë. Nga ana tjetër, edhe sikur të ndodhë, gjë që është krejtësisht e pamundur, që ajo të ishte varrosur e gjallë, nuk do ta ketë kaq lehtë të përgjigjet në celular, sepse nuk do të ketë mjaftueshëm hapësirë manovrimi në arkivolin e ngushtë, ndoshta vetëm do të thërrasë për ndihmë, do të trokasë apo gërvishtë dërrasën e arkivolit që ta dëgjonim, e di edhe vetë si fliste me zë aq të ulët, vazhdoja unë në mbrojtje të dëshirës së saj, duke u përpjekur të paraqes hollësira teknike në mënyrë që ta bëja disi të justifikueshme kërkesën time.

Vëllai ngriti sytë lart dhe doli jashtë në kërkim të valëve të internetit. Më mbeti mua detyrimi të përmbushja dëshirën e fundit të tezes. Kishte momente kur kjo gjë edhe mua vetë më dukej jashtë çdo arsytimi. Si puna me atë tregimin e Edgar Alen Poes. Po sikur vërtetë të ekzistonte qoftë edhe shansi më i vogël që ajo të ishte varrosur për së gjalli si puna e asaj kushërirës së saj që kishte jetuar në shekullin 19, pranë së cilës qëndronte shtrirë tani. Dola jashtë. Vapa nuk kishte filluar akoma. U ula në kafenenë e afërt në sheshin Gunduliç. Celulari im qëndronte i heshtur nën hije. Sipërfaqja e tij e zezë pasqyronte qiellin. Mes përmes ekranit të fikur fluturoi një pëllumb. E pashë se si kaloi diagonal nëpër ekran, e pastaj u ngrit lart në qiell. Mora aparatin në dorë dhe e ndeza, ndërsa ai vetë, si i mençur që është, u lidh me Wi-fi. Sa hap e mbyll sytë ai hyri në zemrën e qytetit dhe më nxori të dhënat mbi gjërat e afërta që paraqisnin interes. *Visitors can take a walk along the city walls that surrounds Old City. The walk take a couple of hours and offers stunning views od the Dalmatian Coast and dhe bird's eye view of the city. Lovrijanac Fortress is one of the sighs that can be seen from the wall, its an impressive structure built on an outcropping rock. It is located outside the Western wall of*